

INSTITUTI I STUDIMEVE PEDAGOGJIKE

**PROGRAMI I LËNDËS
SË EDUKIMIT QYTETAR
KLASA II**

CIKLI FILLOR I SHKOLLËS 9-VJEÇARE

Tiranë, 2004

HYRJJE

Përmbajtja

Edukimi për qytetari demokratike bazohet në parimet themelore të të drejtave të njeriut, të demokracisë pluraliste dhe shtetit të së drejtës. Ai lidhet, para së gjithash, me të drejtat dhe përgjegjësitë, fuqizimin qytetar, pjesëmarrjen dhe përkatësinë, respektin për diversitetin. Si i tillë ai përfshin të gjitha grupet shoqërore dhe sektorët e shoqërisë.

Qytetaria demokratike bazohet në një metodë shumëpërmasore, që ka në bazë procesin dhe përfshin:

- ⊕ **Përmasën politike**, pjesëmarrja në procesin e marrjes së vendimit dhe në ushtrimin e pushtetit politik;
- ⊕ **Përmasën ligjore**, vetëdija dhe ushtrimi i të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve;
- ⊕ **Përmasën kulturore**, respekti për të gjithë njerëzit, vlerat themelore demokratike, për historinë dhe trashëgiminë e përbashkët dhe njëkohësisht të ndryshme, si dhe ndihma për vendosjen e marrëdhënieve ndërkulturore paqësore;
- ⊕ **Përmasën shoqërore dhe ekonomike**, veçanërisht përpjekjet kundër varfërisë dhe përjashtimit social, përpjekjet për krijimin e formave të reja të punës dhe të zhvillimit të komuniteteve dhe si ekonomia të mund të ndihmojë krijimin e një shoqërie demokratike;
- ⊕ **Përmasa evropiane**, vetëdija për unitetin dhe diversitetin e kulturës evropiane dhe të mësuarit për të jetuar në një kontekst evropian;
- ⊕ **Përmasën globale**, njohja, pranimi dhe nxitja e ndërvarësisë dhe të solidaritetit global.

Synime

Edukimi për qytetari demokratike **synon**:

- ⊕ të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;
- ⊕ të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;
- ⊕ të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe në të mirën e përgjithshme;
- ⊕ të fuqizojë shoqërinë civile përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehje demokratike;

Mbështetur në këto qëllime të përgjithshme, **lënda e edukatës qytetare synon**:

- ⊕ *T'u japë nxënësve njohuritë dhe t'u zhvillojë aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe mënyrat e zbatimit të tyre.*

- *Të zhvillojë aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.*
- *Të zhvillojë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.*

Disa nga konceptet dhe aftësitë bazë të edukimit për qytetari demokratike

Edukimi qytetar demokratik përmbledh në vetvete një tërësi konceptesh ose vlerash themelore që janë të përbashkëta për të gjithë demokracitë moderne. Të kuptuarit ashtu siç duhet i këtyre koncepteve dhe vlerave dhe i marrëdhënieve të tyre në kushtet e ndryshimeve të shpejta, si dhe i rreziqeve që bartin, është kushti paraprak për një pjesëmarrje të efektshme dhe të përgjegjshme të qytetarëve në procesin e rindërtimit demokratik. Ja disa nga këto koncepte:

- *të drejtat e njeriut dhe liritë themelore* (univesaliteti, karakteri i pandashëm dhe i patjetërsueshëm i të drejtave dhe lirive, i standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; legjislatiioni ndërkombëtar i të drejtave të njeriut; të drejtat e trashëguara; institucionet dhe procedurat për zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut);
- *demokracia* (institucionet dhe procedurat; përfaqësimi dhe demokracia pjesëmarrëse; liritë demokratike) *dhe parimet demokratike* (përparësia e ligjit dhe e së drejtës, drejtësia shoqërore; barazia, pluralizmi; kohezioni shoqëror; përfshirja; mbrojtja e minoriteteve, solidariteti; paqja, stabiliteti dhe siguria);
- *qytetari* (fuqizimi dhe përgjegjësia; pjesëmarrje aktive);
- *shoqëria civile* (parimet, institucionet dhe procedurat e një shoqërie civile; fuqizimi i shoqërisë civile; marrëdhëniet me shtetin);
- *zhvillimi* (ndryshime të qëndrueshme).

Përdorimi si duhet i koncepteve dhe i vlerave njerëzore demokratike varet shumë nga zhvillimi i aftësive qytetare të tilla si:

- *të menduarit kritik*: aftësia për të kërkuar, për të analizuar dhe për të zgjedhur informacione, duke shfrytëzuar njohuritë ndërlëndore, shprehite e shumëfishta dhe qëndrimin kritik; aftësia për të marrë vendime mbi bazën e të dhënave dhe për të ndryshuar qëndrimet si rrjedhojë e argumenteve të vlefshme;
- *të menduarit krijues*: aftësia për të zbuluar mënyra të reja dhe të pazakonta për të grupuar faktet në kuadrin e një procesi vendimmarrjeje, që shmang në maksimum përgjithësimet e tepruara, paragjykimet dhe stereotipat;
- *të menduarit e prirur drejt sjelljeve shoqërore dhe shoqërisë*: aftësia për të analizuar faktet dhe problemet dhe për të bërë zgjedhje në interes të nevojave të

të tjerëve dhe të shoqërisë në tërësi, duke luftuar egocentrizmin dhe etnocentrizmin; aftësia për të komunikuar me të tjerët dhe për të mësuar nga përvojat e ndryshme;

- *të menduarit e drejtuar nga e ardhmja*: aftësia për të identifikuar dhe kuptuar problemet dhe për të vlerësuar vendimet në dritën e përvojave, me qëllim që e ardhmja e synuar të jetë më e drejtë.

Përveç të kuptuarit të koncepteve dhe të vlerave themelore dhe fitimit të aftësive themelore për një pjesëmarrje aktive dhe të përgjegjshme, për qytetarin janë të nevojshme edhe një tërësi qëndrimesh aktive shoqërore, të përcaktuara përgjithësisht në kuadrin e pjesëmarrjes dhe të përkushtimit ndaj vlerave të njohura e të pranuar si universale në shoqëri, si:

- përkushtimi ndaj parimit të universalitetit, të ndërvarësisë dhe të pandashmërisë së të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore;
- bindja për vlerën, dinjitetin dhe lirinë e individit;
- përkushtimi ndaj shtetit të së drejtës, drejtësisë, barazisë dhe paanësisë;
- përkushtimi ndaj paqes dhe zgjidhjes pjesëmarrëse, paqësore dhe konstruktive të problemeve shoqërore;
- bindja për vlerën dhe domosdoshmërinë e parimeve, institucioneve dhe procedurave demokratike, si dhe për rëndësinë e veprimit qytetar;
- respektimi i kulturave të tjera dhe i ndihmesës së tyre për njerëzimin; pranimi i parimit të pluralizmit në jetën e përditshme;
- përkushtimi ndaj vlerës së mirëkuptimit të ndërsjellë, të bashkëpunimit, të mirëbesimit dhe të solidaritetit, si dhe ndaj luftës kundër racizmit, paragjyqimeve dhe çdo forme të diskriminimit;
- bindja në rëndësinë e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë personale;
- përkushtimi ndaj parimit të zhvillimit njerëzor të qëndrueshëm, që mban parasysht ekuilibrin ndërmjet zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe mjedisor.

Disa parime metodologjike për zhvillimin e lëndës së edukimit qytetar në shkollë

Edukimi për qytetari demokratike është një proces që zgjat gjithë jetën. Si i tillë ai është proces i të nxënies social, domethënë është të nxënë *për, në* dhe *rreth* shoqërisë, në të njëjtën kohë është të nxënies për të jetuar së bashku. Ai nënkupton demokratizimin e të nxënies duke u përqendruar te nxënësi dhe në pavarësinë e përgjegjësinë e tij në procesin e të nxënies, duke nënkuptuar me këtë edhe bashkërendimin e procesit të të nxënies dhe të mësimdhënies.

Edukimi për qytetari demokratike arrihet nëpërmjet metodave të shumëllojshme e të ndërlidhura të të nxënies, në të cilin ndërthuren lloje të tilla të edukimit si, për shembull, edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe edukimi global, edukimit nëpërmjet medias etj.

Edukimi për qytetari demokratike bazohet në përvojën dhe praktikën vetjake. Si i tillë ai kërkon një kurrikul të hapur që të përfshijë metodat pjesëmarrëse dhe ndërvepruese, të cilat bazohen në të nxënies nëpërmjet përvojës, veprimit dhe bashkëveprimit

Pra, edukimi për qytetarinë demokratike synon të zëvendësojë format tradicionale të mësimdhënies dhe të të nxënësve, në të cilat roli i mësuesit reduktohet në transmetimin e dijeve dhe të aftësive dhe ai i nxënësit në të dëgjuarit pasiv dhe, në rastin më të mirë, në përvetësimin e përmbajtjes së transmetuar. Edukimi për qytetarinë demokratike nënkupton mundësitë e shumta të të mësuarit që ofron “shoqëria e të nxënësve”. Ai del përtej kufijve të shkollës dhe të komunitetit dhe sfidon ndarjen që ekziston ndërmjet edukimit formal dhe atij joformal, ndërmjet veprimtarive kurrikulare dhe atyre jashtëshkollore, si dhe ndërmjet shkollimit dhe shoqërizimit. Si i tillë, ai zhvillon karakterin e ndërsjellë të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënësve dhe nxit këmbimin e vazhdueshëm të rolit të mësuesve dhe të nxënësve. Në të njëjtën kohë, duke u përqendruar në fitimin e aftësive dhe të kompetencave të nevojshme për veprimin dhe ndryshimin shoqëror, edukimi për qytetarinë demokratike ruan të gjitha karakteristikat e një përpjekjeje të paramenduar njerëzore që harmonizon teorizimet dhe diskutimin publik.

Në këtë kuadër, mësuesit duhet të shfaqen më tepër si organizatorë të mundësive të shumëfishta të të mësuarit dhe si ura që lidhin burimet shoqërore me përdoruesit e tyre. Ata ndërmjetësojnë dhe lehtësojnë mundësinë e marrjes së informacionit dhe ndjekin në vazhdimësi sfidat e reja shoqërore, politike dhe teknologjike, si dhe nevojat gjithnjë në rritje të nxënësve të tyre. Nxënësit, gjithashtu, duhet të marrin pjesë aktivisht në vendimet lidhur me procesin edukativ, veçanërisht në ato që lidhen me përmbajtjen, metodat dhe strategjitë e mësimdhënies/të nxënësve për qytetarinë demokratike. Mësimdhënia duhet të bëhet një proces ndërveprues, në të cilin jo vetëm diskutohen qëllimet arsimore, por edhe njihen e shkëmbehen kolektivisht përvojat e fituara

Tërësia e procesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin, karakterizohet nga marrëdhënie të ndërsjella. Vlerësimi i dyfishtë dhe përdorimi i të dhënave cilësore për të matur rezultatet e të mësuarit ushtron ndikim të madh në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënësve. Kjo praktikë bën që si mësuesit, edhe nxënësit të jenë të përgjegjshëm për veprimtarinë e tyre edukative dhe rezultatet e saj.

Çfarë kërkohet nga mësuesi i lëndës së edukimit qytetar?

Rolet dhe kompetencat që mësuesit dhe nxënësit kanë pasur tradicionalisht, sot kanë pësuar ndryshime. Disa nga ndryshimet që kanë ndodhur në kompetencat tradicionale të mësuesve lidhen me:

- *dijet e integruara ndërlëndore përkundrejt dijeve të kufizuara në kuadrin e lëndëve të veçanta* në: lëndët mësimore; teoritë dhe çështjet që lidhen me natyrën dhe zhvillimin njerëzor; përshtatjen e teorive të ndryshme të të mësuarit për arritjen e synimeve të veçanta edukative; (në fushën e sjelljes, të njohurive dhe të humanizmit); parimet e procesit të mësimdhënies/ të të nxënësve; organizimin dhe administrimin e veprimtarive në grup;
- *procesin e shumëfishtë dhe dinamik të mësimdhënies përkundrejt procesit linear dhe statik të saj*, në të gjitha përmasat e tij: a) në përpunimin dhe përcaktimin e objektivave të larmishëm; b) në administrimin elastik të orëve të mësimin dhe të grupeve; c) në shumëllojshmërinë e modeleve të mësimdhënies përmes të mësuarit të hapur dhe në bashkëpunim; d) në vlerësimin e ndërsjellë;

- *synimet edukative të shumëfishta përkundrejt atyre të kufizuara në fushën e njohurive. Të parat marrin parasysh kompleksitetin dhe ndryshimet që ndodhin në botën e sotme dhe mbështeten në angazhimin individual për të përmirësuar kushtet e jetës dhe për të zotëruar shprehitë e nevojshme për veprim.*

Një prej kërkesave më të rëndësishme në fushën e mësimdhënies është bindja e mësuesit në aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe që ai vetë është i aftë t'i mësojë ose t'i ndihmojë për të mësuar. Të mësuarit për qytetarinë demokratike përfshin edhe aftësi të tjera të mësimdhënies që janë të rëndësishme për procesin e aftësimin të nxënësve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm:

- aftësia për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tija;
- aftësia për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve;
- respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;
- aftësia për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;
- aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- bindja në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;
- aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;
- gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësim prej tyre;
- aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuar nga kurrikula e fshehtë.

Mjedisi i të nxënësve të qytetarisë demokratike

Edukimi për qytetari demokratike nxit dhe nxitet nga një mjedis i nxënësve demokratik në shkollë dhe nga një metodë që synon të përfshijë të gjithë shkollën, nga metodat e mësimdhënies dhe të të nxënësve dhe nga pjesëmarrja e nxënësve, e stafit arsimor, e prindërve në marrjen e vendimit dhe sa më shumë të jetë e mundur në kurrikulën e arsimit formal dhe joformal.

Ai kërkon që nxënësit të njihen dhe të pranohen si subjekte të drejtash, nga njëra anë, dhe si bartës të drejtash, nga ana tjetër.

Edukimi për qytetari demokratike zgjerohet dhe mbështetet nga bashkëveprimi krijues ndërmjet institucioneve arsimore dhe të komunitetit, duke nënkuptuar edhe bashkëveprimin ndërmjet të nxënësve formal dhe joformal. Si i tillë ai kërkon mbështetjen e duhur ligjore dhe financiare për zhvillime autonome në të gjitha nivelet.

Edukimi për qytetari demokratike duhet të zhvillohet duke vendosur partneritete ndërmjet aktorëve në edukimin për qytetari demokratike, duke vlerësuar pozitivisht kulturat dhe mënyrën e jetesës demokratike të rinisë dhe në vetëshprehjen dhe aspiratat e nxënësve dhe e të rinjve për t'u dëgjuar, duke e shndërruar këtë në bazë të

edukimit për qytetari demokratike; duke ndërmarrë kërkime që kanë në bazë pjesëmarrjen dhe zbatimin në praktikë të nismave dhe risive në fushën e edukimit për qytetari demokratike, për trajnimin dhe zhvillimin e kurrikulave; duke nxitur informacionin për përdorimin e teknologjive të komunikimit në fushën e arsimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë vlerësimit përzgjedhës me kriterëve të informacionit dhe mbështetjes së nismave e të të drejtës për të shfrytëzuar ICT në fushën e edukimit për qytetari demokratike; duke zhvilluar vetëdijen dhe praktikën e mishërimit të përgjegjësishë shoqërore;

Vlerësimi në lëndën e edukimit qytetar

Standardet e përmbajtjes së lëndës së edukimit qytetar përfshijnë tri elemente të ndërlidhur me njëri tjetrin: njohuritë, aftësitë intelektuale dhe ato të pjesëmarrjes dhe prirjet qytetare. Të marrë së bashku këta elementë përbëjnë bazën për zhvillimin e edukimit qytetar dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve duhet të pasqyrojë nevojën për të vlerësua shkëllën e përvetësimit të këtyre tri elementëve nga nxënësit.

Njohuritë përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetjet të tilla si:

- Cili është thelbi i qytetarisë dhe i jetës qytetare në demokraci?
- Cilat janë bazat mbi të cilat ngrihet sistemi demokratik në vend?
- Si dhe në çfarë shkalle sistemi politik në vend bazohet në qëllimet, vlerat dhe parimet e demokracisë të pranuar gjerësisht nga shoqëria jonë?
- Cili është roli i qytetarit në demokraci? Etj.

Aftësitë intelektuale dhe ato pjesëmarrëse të edukimit qytetar përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar me efektshmëri e në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e zgjidhur sfidat e jetës demokratike në vend.

Aftësitë intelektuale aftësojnë nxënësi të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të qytetarit. Këto aftësi i ndihmojnë qytetarët të identifikojnë, të përfshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet si dhe të vlerësojnë, marrin dhe mbrojnë qëndrime të caktuar për çështje të jetës publike.

Aftësitë pjesëmarrëse aftësojnë qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë jetën publike dhe atë qytetare duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe shprehur qartë idetë dhe interesat e tyre, duke bërë koalicione, kërkuar konsensus, duke bërë marrëveshje dhe duke menaxhuar konfliktet.

Një vlerësim tërësor në lëndën e edukimit qytetar nënkupton edhe vlerësimin, në atë shkallë që kjo është e mundur, të aftësive pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se testimi duhet të përfshijë edhe *matjen e shkallës në të cilën nxënësit kuptojnë përdorimin e duhur të aftësive pjesëmarrëse*. Këtu duhet të sqarohet se në këtë vlerësim nuk përfshihet matja e drejtëpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve, për shembull, në qeverinë e nxënësve në shkollë ose në veprimtari të tjera publike.

Elementi i tretë janë *prirjet qytetare* dhe që përshkojnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve të qeverisjes demokratike.

Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë një anëtar i pavarur i shoqërisë,
- për të respektuar vlerat individuale dhe dinjitetin njerëzor,
- për të marrë përsipër përgjegjësitë personale, politike dhe ekonomike të qytetarit,
- për t'iu bindur “rregullave të lojës”, si pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve,
- për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirëinformuar, të arsyeshme dhe të efekshme
- për të nxitur dhe mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.

Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve duhet të përqendrohet në pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë. **Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet personale të nxënësve të vlerësuar.**

Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare duhet të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale. Për shembull, nxënësit mund t'u kërkohet të përshkruajnë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinionëve të tjerëve. *Po kështu, nxënësve mund t'u matet aftësia për të vëzhguar dhe zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose institucioneve qeverisëse më parimet kushtetuese.*

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kontekste të ndryshme si shtëpi, shkollë, bashkësi, shtet, rajon e më gjerë. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë por edhe zbatohen ato në praktikë.

OBJEKTIVA PER PROGRAMIN E LËNDËS SË EDUKIMIT QYTETAR NË KLASËN Ë DYTË

Njohuri të reja:	27 orë
<u>Orë në dispozicion të mësuesit:</u>	<u>8 orë</u>
Gjithsej:	35 orë

1. Individët, grupet, institucionet (6 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të diskutojë rreth ndryshimeve (në familje, klasë apo shkollë) dhe ngjashmërisë me njëri-tjetrin (p.sh., brezat në familje ndryshojnë nga moshja, detyrat që kryejnë në familje, veshja etj.).
- Të përshkruajë banesën ku jeton duke e krahasuar me banesat e shokëve apo të të afërmëve të tij.
- Të përshkruajë disa nga festat familjare, festat lokale (nëse ka) apo kombëtare.
- Të krahasojë jetesën, banesën, veshjen, ushqimin sot dhe atë të gjyshërve të tij (nëpërmjet fotove, tregimeve).
- Të analizojë ndarjen e detyrave në familjen e tij .
- Të vlerësojë të drejtat dhe detyrat e pjesëtarëve të familjes (prindërve e fëmijëve).
- Të përshkruajë, nëpërmjet shembujve nga jeta e përditshme, si anëtarët e familjes mbështesin njëri-tjetrin.
- Të krahasojë aspekte të ndryshme të jetës në familjen e tij me atë të familjeve të tjera (ushqimi, orëditë, organizimi i kohës së lirë).
- Të dallojë disa forma të komunitetit (lagje, fshati, qytete, rrethe, vendi).
- Të përshkruajë format e lidhjes dhe të komunikimit mes tyre.
- Të përshkruajë disa nga ndryshimet në komunitetin e tij.
- Të japë shembuj që tregojnë për mënyrën e jetesës në komunitetin e tij.
- Të shpjegojë rëndësinë e punës për zhvillimin e komunitetit ku jeton.
- Të njohë njerëzit më të shquar të komunitetit ku jeton.

2. Njerëz, vende, mjedise (5 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të radhisë disa nga rregullat në familje
- Të thotë disa rregulla të lojës që përdor ai ne mjedisin ku luan.
- Të radhisë rregullat në mjediset publike (në kinema, teatër, bibliotekë, muze, ekspozitë).
- Të shkruajë rregullat që përdoren në klasë (me mënyra të ndryshme paraqitjeje).
- Të thotë me fjalët e veta përse i përdor rregullat në lojë.
- Të veçojë njerin nga pjesëtarët e klasës që i zbaton rregullat.
- Të veçojë njerin nga pjesëtarët e klasës që nuk i zbaton rregullat.
- Të sjellë ilustrime nga filmat që ka parë ose nga jeta e përditshme, ku personazhi kryesor të jetë një njeri që i zbaton ose jo rregullat.

- Të radhisë disa nga librat për fëmijë, ku personazhi kryesor konkretizon zbatimin ose jo të rregullave.
- Të radhisë rregullat në mjedise publike.
- Të thotë mendimin e tij për rregullat në familje, në mjedise publike (kinema, teatër, bibliotekë, muze, ekspozitë, palestër).
- Të mbajë qëndrim ndaj personave që nuk i zbatojnë rregullat në mjedise të ndryshme.
- Të përshkruajë si mund të ndryshojnë rregullat në lojë nëpërmjet votimit.
- Të demonstrojë problemet që lindin si rrjedhojë e mungesës së rregullave në mjediset publike.

3. Zhvillimi individual, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë (6 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të radhisë disa nga tiparet që e karakterizojnë atë si njeri ;
- të tregojë ku dallon dhe çfarë ka të ngjashme me shokët e klasës, me anëtarët e familjes (gjyshërit, prindërit, vëllezërit, motrat etj.);
- të përmendë dhe të flasë për disa nga nevojat dhe dëshirat bazë të tij dhe të shokëve duke bërë dhe dallimin ndërmjet tyre:
 - nevojat dhe dëshirat vetjake
 - nevojat e familjes
 - nevojat dhe dëshirat e shokëve etj.;
- të flasë për vlerat dhe rëndësinë që kanë për të ushqimi, veshja, banesa, familja, lojërat, dashuria dhe respekti, librat, mbrojtja nga rreziqet etj.;
- të thotë pse plotësimi i nevojave, si : ushqimi, veshja, banesa, lojërat, mësimi etj., përbën një të drejtë që i takon si atij, edhe të tjerëve;
- të zbulojë të drejtat që lidhen me:
 - familjen
 - punën
 - banesën
 - ushqimin
 - mirësjelljen etj.;
- Të flasë për rëndësinë që kanë të drejtat dhe realizimi i tyre për vete dhe të tjerët;
 - e drejta për t'u ushqyer.

4. Pushteti, autoriteti, qeverisja (4 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përshkruajë llojet e shërbimeve që kryejnë ambulanca, klinika dentare, spitali, farmacia;
- Të përshkruajë mjetet kryesore të komunikimit: telefon, letër, telegram;
- Të diskutojë për shërbimet e policisë rrugore, të rendit publik e financiare;
- Të vlerësojë marrjen e informacionit për ngjarje të ndryshme nga radio, televizioni, gazetat;
- Të demonstrojë aftësi praktike në përdorimin e telefonit dhe shkrimin e një kartoline;
- Të japë shembuj të ndërhyrjes së policisë për ruajtjen e rendit në komunitet.

5. Prodhimi dhe shpërndarja (4 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të tregojë se të mirat që ata mund të kenë, janë të kufizuara;
- Të pranojë se nuk mund t'i ketë të gjitha të mirat dhe shërbimet që dëshiron;
- Të identifikojë disa nga të mirat dhe shërbimet që ai mund t'i ketë dhe ato që nuk mund t'i ketë;
- Të identifikojë disa nga zgjedhjet që ai ka bërë dhe të shpjegojnë pse e ka bërë;
- Të bëjë një listë gjërash që ai mendon se kënaq dëshirat e tij dhe të japë shembuj për to;
- Të zgjedhë një lodër nga një grumbull lodrash dhe të tregojë se nga çfarë hoqi dorë dhe pse;
- Të përshkruajë një situatë që kërkon një zgjedhje, një vendim dhe të tregojë koston oportune, domethënë vlerën e alternativës më të mirë nga e cila është hequr dorë, për shembull:
 - Të analizojë si duhet të ndajë dhe të përdorë kohën e tij të ditës së diel duke marrë parasysh disa alternativa: të luajë me shokët, të mësojë, të shkojë të blejë diçka me prindërit etj.,
 - Të listojë koston e blerjes dhe të mbajtes së një qeni ose maceje në shtëpi;
 - Të listojë përfitimet e mbajtjes së një mace ose qeni në shtëpi;
- Të skicojë veten si punëtor;
- Të listojë shembuj të burimeve të përdorura për prodhimin e disa prej mjeteve që përdoren në familje dhe në shkollë.

6. Rruga (3 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të dallojë rrugën, kthesat dhe përdorimet e tyre, të dallojë situatat kur mjetet mund të kalojnë rrugën e shtruar (për këmbësorët);
- Të radhisë disa nga shenjat e zakonshme që ai sheh ose ka parë dhe të tregojë nëse ato gjenden në rrugën e makinës ose të këmbësorit;
- Të përdorë fjalorin e duhur në një situatë rrugore të sigurt;
- Të radhisë tiparet e përbashkëta të disa mjeteve, për shembull, dritat, targën etj., dhe të krahasojë masat e mjeteve të ndryshme;
- Të përmendë ata që mund ta ndihmojnë të kalojë rrugën dhe të përshkruajë rolet e tyre;
- Të përmendë shprehitë kryesore të nevojshme për përdorimin e rrugës kur është i shoqëruar nga një i rritur ose nga një fëmijë më i madh;
- Të dallojë se disa nga mjediset e lojës janë më të sigurta se të tjerat;
- Të dallojë se njerëzit mund të bëjnë zgjedhje se cilën rrugë të zgjedhin kur ndërmarrin një udhëtim;
- Të identifikojë dhe të ushtrojë në praktikë, në situata të simuluar, sjellje të sigurta kur ecën me biçikletë.